



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Sekretares së Përgjithshme/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary

Nr. 142/2025
Datë: 06/11/2025

Në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës, (GZ, nr. 7, 01 Mars 2019), në përputhje me Ligjin nr. 03/L-048 mbi Menagjimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe Rregullores MF nr.02/2013 për Menagjimin e Pasurisë Jo-financiare në Organizatat Buxhetore, Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M


Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Nr.136/2025, i datës 28.10.2025

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 1.3 e Vendimit Nr.136/2025, të datës 28.10.2025 për emërimin e Komisionit për Inventarizimin e Pasurive, si në vijim:
1.3. Ilir Mazreku- Zyrtar i Lartë për Planifikim, DPSHSF, anëtar.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Anita KALANDERI
Sekretare e Përgjithshme

Vendimi i'u dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit;
- Kabinetit të Ushtruesit të Detyrës së Ministrit të Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;
- Departamentit për Buxhet dhe Financa;
- Departamentit për Shërbime të Përgjithshme;
- Divizionit për Burime Njerzore;
- Të gjitha njësive të përcaktuara në pikën 2 të Vendimit nr.136/2025 të datës 28.10.2025;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarsvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Sekretares së Përgjithshme - Kancelarija Generalnog Sekretara - Office of the Secretary General

Nr. 136/2025
Datë: 28/10/2025

Në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7, 01 mars 2019), në përputhje me Ligjin nr. 03/L-048 mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe Rregullores MF nr. 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë Jo-financiare në Organizatat Buxhetore, Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë nxjerr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e Komisionit për Inventarizimin e Pasurive

1. Emërohet Komisioni për Inventarizimin e Pasurive si në vijim:
 - 1.1. Resul Jashari – Zyrtar i Lartë i TI-së, DSHP, Kryesues;
 - 1.2. Fisnik Zabeli – Zyrtar i Lartë për Përkthim Shqip - Serbisht dhe Anasjelltas, DSHP, anëtar;
 - 1.3. Sadedin Gerguri – Zyrtar i Logjistikës, DSHP, anëtar.
2. Komisioni i emëruar nga pika 1 e këtij Vendimi do të bëjë Inventarizimin e Pasurive si në vijim:
 - 2.1. Kabinetit të Ushtruesit të detyrës së Ministrit të Drejtësisë;
 - 2.2. Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;
 - 2.3. Departamentit për Shërbime të Përgjithshme;
 - 2.4. Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave;
 - 2.5. Departamentit Ligjor;

- 2.6. Departamentit për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika;
 - 2.7. Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar;
 - 2.8. Departamentit për Qasje në Drejtësi, Drejtësi Tranzicionale dhe Mbështetje të Viktimave të Krimit;
 - 2.9. Departamentit për Politika të Shërbimeve Sociale dhe Familjare;
 - 2.10. Departamentit për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë të Punës së Profesioneve të Lira;
 - 2.11. Departamentit për Buxhet dhe Financa;
 - 2.12. Divizionit të Prokurimit Publik;
 - 2.13. Divizionit për Auditim të Brendshëm;
 - 2.14. Divizionit për Komunikim Strategjik me Publikun;
 - 2.15. Divizionit për Koordinimin e Procesit për Mbrojtje Juridike dhe Mbështetje Financiare për Personat Potencialisht të Akuzuar nga Gjykata Speciale.
 - 2.16. Avokaturës Shtetërore; si dhe
 - 2.17. Inspektoratit për Mbikëqyrjen e Punës së Institucioneve Korrektuese dhe Drejtorive Rajonale Sprovuese.
3. Anëtarët e Komisionit janë të obliguar që të regjistrojnë inventarin që është në posedim të zyrtarëve, hapësirave të punës, regjistrimin e gjendjes në depon e aseteve dhe logjistikës nga pika 1 e këtij Vendimi;
 4. Komisioni është i obliguar të hartoj Raportin e përgjithshëm – përfundimtar mbi gjendjen e aseteve dhe ta dorëzojë atë tek Sekretarja e Përgjithshme;
 5. Obligohen Zyrtarët përgjegjës të njësive nga pika 2, që të caktojnë një zyrtar i cili do të ndihmojë komisionin gjatë Inventarizimit të pasurive të tyre, duke ju siguruar qasje të nevojshme Komisionit, me qëllim të realizimit të detyrave dhe përgjegjësi që ka ky komision;
 6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Anita KALANDERI
Sekretare e Përgjithshme

Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit;
- Kabinetit të Ushtruesit të detyrës së Ministrit të Drejtësisë;
- Të gjitha Njësive të pikës 2 të këtij vendimi;
- Departamentit për Buxhet dhe Financa;
- Divizionit për Burime Njerëzore;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.